

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER DIANA F. HOXHA



V2024010900041757392

DATE 10/05/2024
NR REP 1183



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 10.05.2024, para meje Notere Diana F. Hoxha, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, me zyrë në adresën Durres, NR.4/Rajoni 1, Skenderbej/Egnatia, Pallati 1182, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Shoqëria "AI DUE FRATELLI" srl, regjistruar si person juridik në Itali, me Kod Fiskal IT04756110278, me seli ligjore ne: Sestiere San Marco n. 611/616 – Venezia (VE), përfaqësuar nga **Juljan Musabelliu**, atësia Shkelqim, amësia Zadeko, shtetas Italian, lindur në Skrapar dhe banues në Itali, me adresë Via Delle Sirene (Lido),5 Venezia (Ve), lindur më 21/12/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. CA86507AF dhe **Ledjo Musabelliu**, atësia Shkelqim, amësia Zadeko, shtetas Italian, lindur në Skrapar dhe banues në Itali, me adresë Via Delle Sirene (Lido),5 Venezia (Ve), lindur më 24/04/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. CA09452CJ;

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt Themelimin e shoqerise "AI DUE FRATELLI" shpk date 10.05.2024", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

DIANA F. HOXHA





AKT THEMELIMI
Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“AI DUE FRATELLI “ shpk

Sot, më date 10/05/2024 (Dymije e njezet e kater) ne Durres:

Shoqëria “AI DUE FRATELLI” S.R.L, me seli ligjore ne: Sestiere San Marco n. 611/616 – Venezia (VE) dhe Codice Fiscale/ Nipt IT04756110278, e perfaqesuar nga ortaket e saj z. Juljan Musabelliu lindur ne Skrapar (ALB), me 21/12/1975 rezidente ne Venezia (VE) – fraksion Lido, ne Rruga Perasto n. 8/A, me kod fiskal MSB JJN 75T21 Z100N dhe z. Ledjo Musabelliu lindur ne Skrapar (ALB), me 24/04/1987 rezident ne Venezia (VE) - fraksion Lido, ne Rruga Perasto n. 8/A, me kod fiskal MSB LDJ 87D24 Z100D;

Te cilet kane redaktuar kete akt ne të cilin parashikohet si më poshtë:

Neni 1

Personat e siperpermendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe me liri të plotë veprimi, te autorizuar nga Vendimi i shoqërisë Italiane “AI DUE FRATELLI” S.R.L i dates 16.04.2024 dhe në bazë të ligjeve shqiptare, themelojne shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar: **“AI DUE FRATELLI” shpk, me ortak te vetem 100% te kuotave “AI DUE FRATELLI” srl, me seli ligjore ne: Sestiere San Marco n. 611/616 – Venezia (VE) dhe Codice Fiscale/ Nipt IT04756110278.**

Bazuar ne nenin 95 te ligjit 9901, shoqëria do te **administrohet nga nje keshill Administrimi:**

- Z. Juljan Musabelliu, lindur ne Skrapar (ALB), me 21/12/1975 rezidente ne Venezia (VE) fraksion Lido, ne Rruga Perasto n. 8/A, me kod fiskal MSB JJN 75T21 Z100N, President i keshillit te administrimiti i cili do te nominohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vitesh.
- Z. Ledjo Musabelliu, lindur ne Skrapar (ALB), me 24/04/1987, rezident ne Venezia (VE) - fraksion Lido, ne Rruga Perasto n. 8/A, me kod fiskal MSB LDJ 87D24 Z100D, administrator i deleguar i cili do te nominohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vitesh.

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do të konsiderohet i përshtatshëm nga ana e saj dhe me aprovimin e organeve kompetente (Qendra Kombëtare e Regjistrimeve).

Neni 2

Shoqëria **“AI DUE FRATELLI” shpk**, do te gëzoje statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi.

Selia e saj do të jetë ne Durres në adresen: Lagjia 3, Z. K.8514, Sheshi Iliria, Egt Center, kati 2, nr.pasurie 3/319-N18.

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.
Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin “AI DUE FRATELLI” SHPK

Neni 3

Aktiviteti i Shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet, me përjashtim të shperberjes ose zgjatjes së parakohshme.

Neni 4

Shoqëria “AI DUE FRATELLI” shpk do të ketë si objekt:

- Menaxhimin e hoteleve dhe restoranteve,
- Tregtimin me shumicë dhe pakicë të ushqimeve dhe pijeve, në çdo mënyrë.
- Aktivitetin imobiliar të pasurive të paluajtshme dhe dhënies me qira të aseteve të veta dhe të palëve të treta,
- Ndertimtari në çdo fushë.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet dytësor dhe jo të përhapur në lidhje me qëllimin e sipërpërmendur, çdo operacion tregtar (përfshirë import-eksportin) të nevojshëm ose të dobishëm për arritjen e qëllimit të saj, dhe gjithashtu mund të kryejë çdo punë artizanale, operacionet industriale, financiare, të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të paluajtshme, gjithashtu për qëllime të investimit të kapitalit dhe rezervës (me përjashtim të çdo veprimtarie brokerimi të letrave me vlerë dhe mbledhjes së kursimeve), dhe në çdo rast çdo aktivitet tjetër të lidhur dhe/ose plotësues me ato të përcaktuara më sipër., të konsideruara të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të konsulcencës tregtare dhe të agjencisë në trajtën e përfaqësueses tregtare.

Shoqëria gjithashtu mund të marrë përsipër, në baza jo të përhapura dhe jo për publikun, interesa, kuota dhe/ose aksione, duke përfshirë aksionet, me qëllim investime të qëndrueshëm dhe jo për vendosje, në shoqëri të tjera, ndërmarrjet ose firma që kanë objektin analog, të ngjashëm, plotësues ose në çdo rast të lidhur me të tjin; të marrë hipoteka dhe hua në përgjithësi, të japë garanci, hipoteka dhe garanci të tjera personale dhe reale, gjithashtu me heqje dorë nga përfitimi i ekzekutimit dhe ndarjes paraprake, të lejojë regjistrimet, transkriptimet dhe shënimet edhe në interes të palëve të treta për angazhimet e të tjerëve. (të gjitha, megjithatë, me përjashtim të aktiviteteve të rezervuara me ligj). Pjesëmarrja në tendera dhe ankande në çdo formë, pjesëmarrja në shoqata dhe organe të tjera kolektive; të krijojë grupime ose shoqata të përkohshme me persona të tjerë juridikë dhe/ose fizikë, edhe për pjesëmarrje në tenderë; blejnë, shesin, shkëmbejnë, marrin dhe/ose japin me qira, përdorin dhe japin hua pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, kompani dhe degë kompanish, pajisje të të gjitha llojeve; marrin dhe/ose japin mandate, me ose pa depozitë, të përfaqësimit dhe si agjensi, si dhe koncesione për firma dhe kompani me qëllime të ngjashme.

-Dhe çdo aktivitet që lejohet nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Kapitali i kësaj shoqërie do të jetë 10'000'000 leke (dhjetemilion leke) i cili do derdhet nga ortaku i vetëm me hapjen e shpk shqiptare dhe llogarive bankare të “AI DUE FRATELLI” shpk, 1 kuote 100% në pronësi të ortakut të vetëm “AI DUE FRATELLI” S.R.L, sic është shprehur në nenin 1.

Neni 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga aktiviteti i kësaj shoqërie, nëse do të shpërndahej, do t'i caktohet ortakut/ortakeve në bazë të kuotes/ kuotave së pjesëmarrjes që disponojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 7

Për detyrimet ndaj të tretëve që do të krijohen gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet eskuzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ortakut nuk do të ketë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përveçse brenda kufijve të kapitalit të vetë shoqërisë.

Për më tepër, me nënshkrimin e këtij akti, aksionari merr përsipër personalisht, në mënyrë të pakufizuar dhe të përbashkët që të mbaj të padëmshëm administratoret e shoqërisë nga çdo detyrim për taksat e kontributet që shoqëria i detyrohet shtetit shqiptar. Përgjegjësia e pakufizuar dhe e përbashkët e ortakut mbetet në fuqi edhe për pagesat që shoqëria i detyrohet personelit të brendshëm dhe të jashtëm.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri dhe filialet e saj rregullohen përmes kontratave specifike.


Neni 9

Dispozita më të thelluara mbi organizimin e kësaj shoqërie janë të specifikuar në statutin e shoqërisë.

Themeluesit e shoqërisë e kanë lexuar këte akt-themelimi, e kanë konsideruar të pranueshëm ndaj vullnetit të tyre dhe e firmosin pa kundërshtime.

**Ortaku
"AI DUE FRATELLI" SRL
Perfaqesues Ligjor**

JULJAN MUSABELLIU



LEDJO MUSABELLIU

